



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 204/5 prot.

Tiranë, më 12.6.2020

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 241, datë 26.2.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Irena Gjoka
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 28.5.2020, është njoftuar vendimi nr. 241, datë 26.2.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Irena Gjoka, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, sot Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 241, datë 26.2.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit znj. Irena Gjoka ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si KLGJ), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Irena Gjoka¹”, ka referuar:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit znj. Irena Gjoka, nr.*** prot., datë ***.11.2017², ka referuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka”.

2.3 KLGJ, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin³ për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit znj. Irena Gjoka.

3. Hetimi, vlerësimi dhe përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në Deklaratën “Vetting” pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës... Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjyqësor çmon se pasaktësitë në deklarim dhe balanca negative e fondeve në vitin 2014, prej 146,111 lekësh, nuk është e mjaftueshme që të pasjellë

¹ Shkresa e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë ***.7.2018.

² Deklasifikuar plotësisht me Vendimin e KDZH-së nr. ***, datë ***.9.2019.

³ Raporti i KLGJ-së nr. *** prot., datë ***.7.2019.

aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analizë kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit... Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklarimet e pasakta të konstatuara si më sipër, nuk duhet të ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se, për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, ato nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut të drejtësia [...] (f. 28-29 e vendimit).

3.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës [...] (f. 29 e vendimit).*

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e hartuar nga KLGJ, hetimit dhe vlerësimit të denoncimeve nga publiku dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka konkluduar se: [...] *nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit... Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional... Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...] (f. 33-34 e vendimit).*

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, e për këto arsye, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: [...] *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar [...].*

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisionerët Publikë është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48 - 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është

i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, në gjendjen që janë aktet, duke vlerësuar nëse vendimmarrja është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

9. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij ligjore, nga shqyrtimi i vendimit nr. 241, datë 26.2.2020, të Komisionit, çmon se ky vendim është rrjedhojë e interpretimit dhe e zbatimit të gabuar të dispozitave kushtetuese dhe kuadrit ligjor të zbatueshëm, si dhe bazohet në një vlerësim jo të drejtë të provave të administruara. Në referencë të zbatimit të dispozitave përkatëse të Kushtetutës dhe ligjit të posaçëm, lidhur me faktin/et për çështjen objekt ankimi, Komisioneri Publik vlerëson se ky vendim i Komisionit është i cenusshëm në tërësinë e tij, shkak për të cilin i kërkohet Kolegjit të ushtrojë juridiksionin e tij kontrollues dhe rivlerësues, duke e ndryshuar atë.

10. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni, sa i takon kriterëve të rivlerësimit, bazuar në kërkesat e dispozitave të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit të posaçëm nr. 84/2016, Komisioneri Publik konstaton se përfundimet e arritura nga Komisioni janë të gabuara dhe jo në pajtueshmëri me provat e administruara.

11. Në këtë drejtim, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (periodike dhe ajo *Vetting*), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur. Me pasuri të ligjshme (e paluajtshme/e luajtshme/likuiditetet), për qëllim të këtij përcaktimi kushtetues, konsiderohen vetëm ato të cilat janë deklaruar (saktësisht dhe mjaftueshmërisht) dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

12. Ndërsa objekti i vlerësimit për kriterin e aftësive profesionale materializohet në kontrollin dhe hetimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, përkatësisht ligji nr. 96/2016. Në të njëjtën normativë ligjore gjen rregullim dhe objekti i vlerësimit i kriterit të figurës së subjektit të rivlerësimit.

13. Për rastin objekt ankimi, Komisioneri Publik vëren se Komisionit i kanë rezultuar rrethana dhe fakte të provuara, se subjekti: *Për kriterin e pasurisë*, nuk ka dhënë prova konkrete dhe shpjegime bindëse lidhur me burimin e krijimit të pasurive të subjektit dhe personave të lidhur me të, dhe ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme ndër vite, si dhe rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme financiare.

13.1 Duke u bazuar në interpretime dhe në zbatim të gabuar të dispozitave të aneksit kushtetues, ligjit të posaçëm dhe vlerësimit jo objektiv të fakteve, udhëhequr nga parimi i proporcionalitetit për deklaratimet e pasakta në mënyrë të përsëritur ndër vite, zbatimi i të cilit (*parimi i*

proporcionalitetit) në gjykimin e Komisionerit Publik nuk është i përshtatshëm në rrethanat konkrete të provuara, ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit znj. Irena Gjoka.

14. Në të tilla kushte, ku subjekti rezulton me mospërbushje të kërkesave të parashikuara në aneksin e Kushtetutës dhe në legjislacionin e posaçëm, për kriteret e procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik çmon se, referuar përmbajtjes të nenit 4, pika 2, të nenit 59, pika 1 dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, gjykimi i rrethanave ligjore dhe i fakteve të mësipërme nga ana e Kolegjit është i nevojshëm, me qëllim për të arritur në një vendimmarrje të Kolegjit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

15. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ankimon vendimin nr. 241, datë 26.2.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A Kontrolli i pasurisë

16. Si një ndër tri kriteret e procesit të rivlerësimit kalimtar, kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë e gjejmë të materializuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku realizimin e qëllimit të nenit 179/b, pika 1, të Kushtetutës, këto norma e konkretizojnë në identifikimin e subjekteve që: (i) kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose (ii) nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin kushtetues për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, ekzistencën e të ardhurave të ligjshme dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

17. Komisioneri Publik, ndryshe nga arsyetimi dhe përfundimet e Komisionit për këtë kriter, në rastin konkret konstaton se subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit pas kalimit të barrës së provës, që në kuptim dhe zbatim të nenit D, paragrafi 3 i aneksit të Kushtetutës, ta bënte atë subjekt të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, e për pasojë, të sillte konfirmimin në detyrë të tij.

18. Pasuritë nga subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, janë deklaruar fillimisht në “*Deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie*” (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dorëzuar në ILDKP më datë 16.3.2004, deklaratat periodike për vitet 2004 - 2016, dhe në *Deklaratën “Vetting”* (këtu e në vijim referuar si D-Vett.) dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017. Pasuritë e deklaruara janë si vijon:

19. Pasuria nr. 1 - Në D-Vett. deklarohet: “Apartament” me sipërfaqe 71 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f.***, rr. “***.***.***”, Tiranë, fituar me kontratën e sipërmarrjes nr.*** rep., nr. *** kol., datë 6.10.2005, me vlerë 45.885 euro, me pjesë takuese 100% në pronësi të subjektit. Në vitin 2007 është formalizuar kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. *** rep., nr.*** kol., datë 12.2.2007. Si burim i krijimit të pasurisë deklarohet: (i) kursime nga të ardhurat nga paga ndër vite; (ii) hua në shumën 2.000.000 lekë nga të tretët.

19.1 Në DV-2005 nga subjekti deklarohet: “Apartament” banimi me sipërfaqe ndërtimore 80.5 m², Tiranë, bazuar në kontratën noteriale të sipërmarrjes datë 6.10.2005, për vlerën 45.885 euro, pjesa takuese e subjektit 100%. Në deklarimin e këtij viti, subjekti ka deklaruar të shlyer tërësisht vlerën e apartamentit prej 45.885 euro dhe si burim i krijimit të pasurisë deklarohet: (i) Tërheqje depozite, Banka ***, në shumën 93.000 lekë; (ii) Tërheqje depozite *** Bank, në shumën 800.000 lekë; (iii) 15.000 euro kursime të vitit 2005; (iv) Tërheqje dhe mbyllje depozite në Bankën ***.*** pjesa që zotëron, në shumën 4.000 USD.

19.2 Nga verifikimi i këtyre akteve, administruar si provë nga ana e Komisionit, në kuptim të nenit 32, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, mes të tjerash, rezulton se deklarimi i burimit të krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie është i ndryshëm. (i) Në D-Vett., subjekti ka deklaruar si burim të krijimit të saj huan nga të tretët, në vlerën 2.000.000 lekë, ndërkohë në deklaratën e interesave periodike/vjetore 2005 ka deklaruar këtë detyrim ndaj vëllait ***.***, në shumën 20.000 euro. (ii) Për shumën 15.000 euro në D-Vett., si burim për blerjen e apartamentit, subjekti nuk ka deklaruar saktësisht burimin e krijimit të kësaj shume, pasi nuk rezulton të ketë deklaruar të ardhurat e z. ***.*** dhe dhuratën e prindërve të saj, deklaruar në procesverbalin datë 2.10.2014 të ILDKPKI-së. Ndërsa në DV- 2005, kjo shumë prej 15.000 euro deklarohet si kursime të vitit 2005.

19.3 Nga aktet e administruara në dosje rezulton po ashtu se, në datë 6.10.2005, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e porositësit, dhe shoqëria “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, kanë lidhur një kontratë sipërmarrje nr.*** rep., nr. *** kol., datë 6.10.2005, me vlerë 45.885 euro. Referuar të drejtave dhe detyrimeve të palëve të parashikuara në kontratë, e që në bazë të parashikimeve të K. Civil kanë vlerën e ligjit mes palëve kontraktuese, pagesa e plotë e çmimit është likuiduar në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

19.4 Referuar kontratës së sipërmarrjes datë 6.10.2005, si dhe deklarimeve të subjektit në DV-2005, subjekti deri në datë 6.10.2005 ka shlyer tërësisht detyrimin për apartamentin, në shumën 45.885 euro. Për këtë arsye, analiza financiare për çdo zë të ardhurash, të deklaruar nga subjekti si burimet e krijimi për këtë aset, do të shtrihet nga momenti të krijimit të burimeve të deklaruara nga ana e subjektit deri në tetor 2005.

19.5 Fillimisht mbi burimin e deklaruar kursime personale, detajuar si më poshtë:

19.6 (i) Tërheqje depozite, Banka ***, në shumën 93.000 lekë. Në DV- 2003, subjekti ka deklaruar pranë Bankës *** depozitë në shumën 93.000 lekë, me burim kursime nga puna. Me shkresën nr. *** prot., datë ***.2.2019, *** Bank (më parë Banka ***), nuk konfirmon llogari bankare në emër të subjektit të rivlerësimit.

19.7 (ii) Tërheqje depozite *** Bank, në shumën 800.000 lekë. Në DV- 2003, subjekti ka deklaruar depozitë në *** Bank, në shumën 800.000 lekë, me burim kursime nga puna. Me shkresën nr. *** prot., datë ***.3.2019, *** Bank konfirmon se subjekti i rivlerësimit, për periudhën 2001-2005, ka pasur depozita bankare aktive në monedha të ndryshme (lekë, CHF dhe USD), dhe ka vënë në dispozicion dhe lëvizjet respektive për këto llogari. Nga verifikimi i llogarisë në lekë, rezulton se deri në datën 31.12.2003 shuma e depozituar ka qenë në vlerën 800.000 lekë.

19.8 Gjatë vitit 2004 konstatohet se në këtë depozitë janë shtuar dy shuma nga 200.000 lekë secila, respektivisht në shkurt 2004 dhe në maj 2004. Në datën 1.12.2004 është tërhequr tërësisht

shuma e depozituar së bashku me interesat e maturuara, në vlerën prej 1.254.484 lekë. Në DV-2003 dhe DV-2004 nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar *shtesat në këtë depozitë dhe destinacionin e shumës së tërhequr* në dhjetor 2004, prej 1.254.484 lekësh.

19.9 Në datën 14.9.2005, në këtë depozitë është depozituar *cash* shuma prej 1.700.000 lekësh, e cila është tërhequr *po cash* në datën 5.10.2005.

19.10 Duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar saktësisht dhe qartësisht, Komisioni e ka pyetur subjektin lidhur me: **i)** burimin e krijimit të shumës 1.700.000 lekë dhe **ii)** destinacionin e përdorimit të saj. Në përgjigje të pyetësorëve dhe shpjegimeve të subjektit të dhëna pas rezultateve të hetimit datë 17.2.2020, subjekti ka deklaruar: “...Në datën 19 shtator 2003 kam depozituar në llogarinë bankare shumën 800.000 lekë⁴. Pas dy depozitimeve nga 200.000 lekë secila, në shkurt dhe në maj 2004, kjo llogari ka arritur shumën 1.254.484 lekë. Në datën 23 dhjetor 2004 e kam mbyllur këtë depozitë dhe shumën e mësipërme të tërhequr e kam përdorur për pagesën e këstit për blerjen e apartamentit, likuiduar ndërtuesit në tetor 2005, për shkak të vonesave në ndërtim...”.

19.11 Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me mosdeklarimin e *cash-it* në vitin 2004 në shumën 1.254.484 lekë. Në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ, datë 17.2.2020, subjekti ka deklaruar: “...Ka qenë një interpretim i gabuar i ligjit nga ana ime në vitin 2004, që gabimisht nuk kam deklaruar shtesën në shumën 454.484 lekë, pasi unë mendoja për sa kohë kisha deklaruar në vitin 2003 shumën 800.000 lekë dhe duke marrë në konsideratë faktin se në vitin 2004 kisha kryer transaksione bankare të depozitave në bankë, si dhe tërheqjen e shumës 1.254.484 lekë e kam marrë të mirëqenë që, për sa kohë ishin veprime bankare, ato kishin lënë gjurmë dhe unë nuk kisha gjykuar se duhet të deklaroja shtesën në shumën 454.484 lekë, me burim të ardhurash kursimet nga paga. Sjellë në vëmendje se kanë qenë fillesat e deklarimit viti 2003 dhe 2004...”.

19.12 Komisioni, lidhur me mosdeklarimin e kursimeve në *cash*, arsyeton se ⁵: [...] *Subjekti ka kryer tërheqjen e kësaj shume në fund të vitit 2004 dhe e ka rikthyer sërish në bankë në datën 13.9.2005, duke shtuar dhe kursimet e vitit 2005 ...Komisioni krijon bindjen e mbështetur në prova se mosdeklarimi i shtesës së të ardhurave në shumën 454,484 lekë në DV-2004 nuk përbën mungesë të burimeve financiare për blerjen e apartamentit [...].*

19.13 Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, kursimet e poseduara në *cash* në DV-2004, dhe si rrjedhojë nuk justifikohet me të ardhura të ligjshme burimi i shumës 1.700.000 lekë, i deklaruar si pagesë për blerjen e pasurisë nr.1. Ky konkluzion i Komisionerit Publik mbështetet në vendimet e Kolegjtit (JR) nr. 7/2019⁶, (JR) nr. 11/2019⁷, (JR) nr. 19/2019⁸, (JR) nr. 20/2019⁹ dhe (JR) nr. 29/2019¹⁰.

⁴ Si burim deklarohen kursimet nga paga, që për periudhën 1 prill 2002 deri në 22 shtator 2003, janë në shumën 811.366 lekë, sipas vërtetimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, bashkëlidhur në pyetësorin datë ***.10.2019.

⁵ Referohuni vendimit të KPK-së (f. nr. 9).

⁶ Në prg. 39 të tij.

⁷ Në prg. 27.12.18 të tij.

⁸ Në prg. 84 të tij.

⁹ Në prg. 55 dhe 56 të tij.

¹⁰ Në prg. 31 të tij.

19.14 (iii) **Mbi 15.000 euro kursime të vitit 2005.** Në DV-2005, subjekti ka deklaruar kursime nga paga 15.000 euro. Për sa i përket burimit të krijimit të shumës 15.000 euro ka *mospërputhje të deklarimeve* në D-Vett., DV-2005, ballafaquar me deklaramet e saj para ILDKPKI-së dhe deklarimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ.

19.15 Lidhur me burimin e shumës prej 15.000 euro, deklaruar në DV-2005, ILDKPKI e ka pyetur subjektin mbi likuiditetin *cash*, i cili nuk rezulton të jetë deklaruar më parë. Subjekti në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë 2 tetor 2014, ka deklaruar: “ *Një pjesë ka qenë kursim i atij viti, një pjesë ka qenë kontribut i ish-bashkëjetuesit tim dhe një pjesë tjetër ka qenë dhuratë që më bënë prindërit për blerjen e apartamentit me rastin e futjes në apartamentin e ri, në nëntor 2005*”.

19.16 Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime lidhur me mospërputhjet e mësipërme. Për sa i përket mosdeklarimit të të ardhurave të z. ***,*** dhe kontributin e prindërve të saj, subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 4.12.2019, ka shpjeguar se “ *... nuk janë deklaruar në Deklaratën “Vetting” si burim të ardhurat e z. *** dhe as të familjes sime, pasi deri në dhjetor të vitit 2005 kam jetuar së bashku me prindërit dhe kontributi i tyre në blerjen e apartamentit ka qenë fakti që nuk kam kryer shpenzime jetike, pasi çdo e ardhur e pagës sime kursehej në llogari...*”.

19.17 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, datë 17.2.2020, subjekti ka deklaruar: “*Më lejoni të shpjegoj, se deklarimi im në procesverbalin e vitit 2014 në ILDKPKI, se burimi i shumës 15.000 euro për blerjen e apartamentit në DV-2005... ka qenë në fakt për të sqaruar fillimin e bashkëjetesës me z. *** dhe përgjigja e dhënë nuk ka të bëjë me krijimin e pasurisë së paluajtshme në vetvete (apartamentin), por me shpenzimet për jetesën (ushqimin) dhe mobilimin me sende të luajtshme të apartamentit. Kjo sqaron se objekti i deklarimit në procesverbalin e vitit 2014 në ILDKPKI ishte i ndryshëm nga ai i deklarimit të pasurisë në DV-2005”.*

19.18 Lidhur me këto mospërputhje, Komisioni ka arsyetuar se¹¹: *[...] në kohë të ndryshme ka deklaruar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie në mënyra të ndryshme, por që këto deklarime nuk cenojnë thelbin e burimit të pasurisë së saj, i cili është të ardhurat nga paga e subjektit... Mospërputhja midis deklarimeve të subjektit nuk ka ardhur si pasojë e qëllimit të saj për të fshehur apo deklaruar në mënyrë të pasaktë këtë pasuri, por siç rezulton, ajo është përpjekur për të detajuar burimin e kësaj pasurie*”. Në vijim, Komisioni arrin në konkluzionin “*...subjekti ka deklaruar saktë këtë pasuri, si dhe burimin e ligjshëm të saj në D.Vett.[...]*”.

19.19 Ndryshe nga Komisioni, Komisionerit Publik i rezulton se: (i) në D-Vett., burimi i pasurisë nr.1 nuk është deklaruar saktësisht dhe plotësisht, pasi nuk ka deklaruar shumën prej 15.000 euro. (ii) Në analizë të burimit të deklaruar (15.000 euro kursime nga pagat e subjektit për vitin 2005) rezulton se të ardhurat nga paga të subjektit¹² deri në momentin e pagesës së kryer nga subjekti, datë 6.10.2005, nuk mbulojnë kursimin e deklaruar në shumën 15.000 euro.

19.20 (iv) **Mbi tërheqjen dhe mbylljen e depozitës në bankën ***,***,** për pjesën që zotëron subjekti, në shumën 4.000 USD. Në DV-2004, subjekti ka deklaruar depozitë bankare në shumën 23.000 USD, nga të cilat pjesa që zotëron subjekti është 4.000 USD. *Burim krijimi* - kursime nga paga.

¹¹ Referohuni vendimit të KPK-së (f. 7).

¹² Të ardhurat e subjektit janar- tetor 2005 janë në shumën rreth 685.000 lekë.

19.21 Në rubrikën “Informacion konfidencial” të kësaj deklarate vjetore, subjekti ka deklaruar: *“Në emrin tim është një depozitë, pa afat, të cilat janë të familjes sime të origjinës, me të cilën veprojmë në emër dhe për llogari të prindërve të mi pensionistë dhe dy vëllezërve në emigracion”*.

19.22 Lidhur me pjesën kontribuese të subjektit në krijimin e llogarisë 23.000 USD, rezulton se subjekti ka dhënë deklarime kontradiktore referuar deklarimeve gjatë hetimit administrativ, ballafaquar me deklaramet e saj në DV-2004.

19.23 I pyetur mbi burimin e ligjshëm të depozitës 23.000 USD, deklaruar në DV-2004, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, datë 31.10.2019, ka deklaruar se: *“...kjo depozitë është krijuar nga të ardhurat e pagës sime ndër vite, duke filluar që nga viti 1993”*.

19.24 Pas shpjegimit të burimit të ligjshëm, referuar përgjigjes së dhënë më lart, Komisioni ka konstatuar se kjo përgjigje është e ndryshme nga deklarimi i subjektit në DV-2004, ku subjekti deklaroi që vetëm 4.000 USD është kontributi i saj, në depozitën 23.000 USD.

19.25 Pasi Komisioni i ka kërkuar shpjegime lidhur me këtë fakt, në përgjigjen e pyetësorit nr. 2 datë 4.12.2019 dhe shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, datë 17.2.2020, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“ Deklarimi im në DV-2004 se 4.000 USD është kontributi im, ndërsa pjesa tjetër i përket familjes së origjinës, është një pakujdesi nga ana ime, pasi kam dashur të shpreh të kundërtën dhe situata reale është e kundërta. Kjo depozitë, shuma 23.000 USD, është krijuar nga të ardhurat nga puna ime ndër vite qysh në vitin 1993, kur fillova punë. ...Nga maji 1993 deri në dhjetor 2005, unë bashkëjetoja me prindërit, pasi isha beqare. Për këtë periudhë, ne si familje kemi pasur ekonomi të përbashkët deri në dhjetor 2005, prandaj unë depozitën 23.000 USD e kam deklaruar si kursime nga të ardhurat familjare në DV-2004, e konstatuar nga ana juaj... 4000 USD nga të ardhurat e prindërve dhe pjesa tjetër pagat e mia. ... 4.000 USD ka qenë të ardhura nga prindërit, me burime: të ardhura nga qiraja e objektit që shfrytëzohej si godinë, ish-Komuna ***, të ardhura nga pensioni dhe pagat e prindërve, si dhe të ardhurave nga produktet bujqësore¹³ dhe dhuratat që vëllai, ***, **, u ka bërë prindërve në vitin 1998, në vlerën 570.000 lekë, të përfituara nga shitja e makinës. ...Prandaj në Deklaratën “Vetting” unë kam deklaruar si burim të ardhurash pagën time ndër vite, e cila zë 83% të depozitës, në shumën 23.000 USD”*.

19.26 Për të provuar të ardhurat e ekonomisë së përbashkët familjare, subjekti ka paraqitur dokumentacion për: (i) të ardhurat nga pensionet e prindërve për periudhën deri në vitin 2005¹⁴, (ii) të ardhurat e përfituara nga qiradhënia,¹⁵ për vitet 1996-1999, (iii) raport vlerësimi nga vlerësuesi ***, **, të datës ***.12.2019, për z. ***, **, si dhe (iv) deklarata të thjeshta pa datë, të shtetasve ***, ***, dhe z. ***, **, si përfaqësues i shoqërisë “****” sh.p.k.

19.27 Komisioni, pasi e ka shtrirë analizën financiare të ekonomisë së përbashkët familjare të subjektit në periudhën përpara vitit 2001, gjatë vitit 2003 dhe në vijim deri në tetor 2005, ka arsyetuar se ¹⁶: *[...] Subjekti së bashku me familjen e saj të origjinës kanë pasur mundësi për të krijuar depozitën në shumën 23.000 USD, si në rastin kur kontributi i subjektit konsiderohet 4.000*

¹³ Toka ullishte sipas AMTP nr. ***, datë ***.7.1993, përfitur në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, në emër të ***, ***,

¹⁴ Vërtetuar me shkresën nr. *** prot., datë ***.12.2019, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Fier.

¹⁵ Vërtetuar me shkresën nr. *** prot., datë ***.12.2019, të Njësisë Administrative ***, Bashkia Patos.

¹⁶ Referohuni vendimit të KPK-së (f. 11).

USD, ashtu dhe në rastin kur kontributi i subjektit do të konsiderohet 19.000 USD. ...Mospërputhjet e konstatuara në deklarin e subjektit gjatë hetimit do të konsiderohen si pasaktësi, por këto pasaktësi nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkim, për sa kohë nga analiza financiare provohet mundësia e subjektit dhe e familjes së saj të origjinës për krijimin e depozitës në shumën 23.000 USD [...].

19.28 Komisionerit Publik, nga gjendja e akteve të administruara në dosje, i rezulton se ***.*** Bank, me shkresë nr.*** prot., datë ***.11.2019, konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka pasur edhe një llogari në monedhën USD pranë kësaj banke.

19.29 Nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie, konstatohet se veprimi i parë lidhur me shumën 23.000 USD mban datën 5.4.2002. Në vijim, kjo shumë është shtuar nga interesat bankare deri në momentin e tërheqjes në vitin 2005. Si rrjedhim, analiza financiare e Komisionit për krijimin e depozitës 23.000 USD, deklaruar si burim për krijimin e pasurisë nr. 1, duhej të ishte shtrirë fillimisht deri në datën e veprimit të parë.

19.30 Për sa më sipër, na rezulton se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit deri në datën 5.4.2002 janë në shumën 2.448.511¹⁷ lekë, ndërsa *kursimet* në emër të subjektit të rivlerësimit në sistemin bankar në shumën 4.343.097¹⁸ lekë, janë më të larta se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit.

19.31 Edhe nëse marrim në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, mbi ekonominë e përbashkët familjare, rezulton se, deri në prill 2002, *të ardhurat e ligjshme familjare* janë në shumën totale 3.974.289 lekë¹⁹. Ndërkohë, përveç kursimeve në sistemin bankar të subjektit në vlerën 4.343.097 lekë, nga aktet në dosjen gjyqësore provohet edhe blerja e apartamentit në Fier nga vëllai i subjektit, ***.***, në datën 18.1.2001, për vlerën 1.800.000 lekë, vlerë e cila duket se nuk është i përfshirë në zërin “shpenzime” në analizën e Komisionit. Theksojmë se ky apartament nga vetë subjekti është deklaruar si adresë banimi në DV-2003, DV-2004, DV-2005. Për sa më sipër, Komisionerit Publik i rezulton se vetëm shuma e investimeve në pasuri të paluajtshme dhe kursime të depozituara në sistemin bankar deri në prill 2002 (pa llogaritur shpenzime minimale jetese për një familje me 4 persona për periudhën 1993-2002) është në shumën 6.143.097 lekë, konsideruar ndjeshëm më e lartë sesa të ardhurat e dokumentuara.

19.32 Nisur nga arsyetimi i vendimit, edhe pse nuk rezulton që Komisioni të ketë kualifikuar ligjërisht prindërit z. ***.*** dhe znj. ***.*** si person tjetër të lidhur,²⁰ në analizën financiare të tij, ka konsideruar si të ardhura të ligjshme të gjitha të ardhurat e pretenduara nga subjekti që rrjedhin nga ekonomia e përbashkët familjare.

19.33 Komisioneri Publik konstaton se në analizën financiare të Komisionit janë përfshirë të ardhurat e përfituara nga shfrytëzimi i ullinjve të babait të subjektit, z.***.***, për periudhën 1994-2005, mbështetur në akt ekspertimi privat dhe në *deklarata të thjeshta, të disa shtetasve, pa*

¹⁷ Të ardhurat nga pagat e subjektit sipas konfirmimeve të institucionit përgjegjës për periudhën 1993-prill 2002 dhe të ardhurat nga interesat e depozitave bankare pranë *** Bank deri në këtë datë.

¹⁸ Kundërvlera në lekë e depozitës 23.000 USD, e konvertuar me kursin e Bankës së Shqipërisë në datën 5.4.2002, në vlerën 143.15 lekë, si dhe kundërvlerat e depozitave të subjektit të rivlerësimit aktive në dollarë pranë *** Bank, të çelura gjatë vitit 2001, konvertuar në kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2001.

¹⁹ Të ardhurat nga pensionet e prindërve dhe nga pagat e subjektit të rivlerësimit deri në prill 2002, interesat bankare, të ardhurat nga qiraja Komuna *** dhe të ardhurat në shumën 570.000 lekë, dhuruar nga vëllai ***.***, nga shitja e automjetit.

²⁰ Në kuptim të nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

*datë*²¹. Komisioneri Publik, ndryshe nga Komisioni, vlerëson se këto të ardhura nuk bazohen në dokumentacion justifikues për të provuar masën e të ardhurave të pretenduara të realizuara, si dhe faktin nëse për to janë paguar detyrimet tatimore, në mënyrë që të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës. Në këtë pikë, Komisioneri Publik kërkon një qëndrim të qartë dhe ligjor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

20. Mbi huan nga të tretët në shumën 2.000.000 lekë. Në D-Vett., subjekti ka deklaruar si një nga zërat për krijimin e pasurisë nr.1 - hua nga të tretët, në shumën 2.000.000 lekë.

20.1 Në DV- 2005, subjekti ka deklaruar detyrim i pashlyer për blerjen e apartamentit ndaj vëllait tim ***.***, në shumën 20.000 euro. Në DV- 2006, subjekti ka deklaruar detyrim ndaj vëllait në shumën 2.000.000 lekë. Në DV- 2010, subjekti ka deklaruar shlyerjen pjesërisht të këtij detyrimi në shumën 1.000.000 lekë, me burim të ardhurat e bashkëshortit z. ***.***, të përfituara nga shitja 10% e aksioneve të shoqërisë “****” sh.a. Në DV- 2016, subjekti ka deklaruar shlyerjen e pjesës së mbetur të detyrimit në shumën 1.000.000 lekë, me burim të ardhurat e bashkëshortit z. ***.***, siguruar nga shitja e mjetit Mercedes Benz, në shumën 900.000 lekë dhe diferenca nga kursimet vjetore.

20.2 Duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar qartësisht, Komisioni e ka pyetur subjektin lidhur me monedhën në të cilën e ka detyrimin e deklaruar. Në përgjigjet e pyetësorit nr.1, datë 31.10.2019, subjekti ka deklaruar se: “...*deklarimi në DV-2005 është një lapsus, për sa i përket llojit të monedhës, ka ndodhur një ngatërresë njerëzore dhe është deklaruar gabimisht...*”, shpjegim të cilin Komisioni e ka konsideruar bindës.²²

20.3 Bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni e ka konsideruar vëllain e subjektit, z. ***.***, si person tjetër të lidhur dhe ka hetuar lidhur me të ardhurat e realizuara prej tij.

20.4 Për të provuar aftësinë huadhënëse të vëllait të saj, subjekti i ka paraqitur Komisionit si provë shkresore: (i) Dokumentacion nga organet tatimore greke, që vërteton të ardhurat e ligjshme të huadhënësit dhe të bashkëshortes së tij, në periudhën 2001-2005, shoqëruar me vulë apostile. (ii) Raport vlerësimi nga vlerësuesi ***.***, të datës ***.12.2019, për të ardhurat nga ullahtet, z. ***.***. (iii) Deklarata të thjeshta pa datë, të shtetasve ***.***, ***.***, si përfaqësues ligjor i shoqërisë “****” sh.p.k., të z. ***.***, si përfaqësues ligjor i subjektit “****” sh.p.k. (iv) Tetë mandate pagese të lëshuara (2011-2013) nga subjektit “****” sh.p.k.

20.5 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 4.12.2019, i pyetur nga Komisioni mbi justifikimin e burimit të ligjshëm të huas, subjekti deklaroi se: “...*përveç të ardhurave më sipër nga punësimi në shtetin grek, im vëlla, ***.***, ka përfituar tokë bujqësore, ullahte. ...Duke filluar nga viti 1993, ai ka poseduar dhe gëzuar këtë pasuri dhe ka siguruar të ardhura nga shfrytëzimi i saj... Sipas raportit të vlerësimit datë 10.12.2019, përgatitur nga eksperte e licencuar, rezulton se kjo pasuri ndër vite ka sjellë të ardhura të konsiderueshme, të cilat deri në vitin 2005 (që është edhe viti i dhënies së huas) përlllogarit në shumën 4.157.550 lekë”.*

²¹ Dy deklarata të shtetasve ***.***, ***.***.

²² Referohuni vendimit të KPK-së (f. 12).

20.6 Nga analiza financiare e Komisionit për të ardhurat e ligjshme të vëllait ***.***²³, ka rezultuar se ai ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 2.000.000 lekë, në vitin 2005.

20.7 Komisioneri Publik vëren se, referuar akteve të administruara në dosjen e Komisionit mbi të ardhurat e ligjshme të z. ***.*** nga emigracioni, i rezulton se të ardhurat neto të familjes së huadhënësit ***.***, për periudhën deri në vitin 2005 janë në shumën 29.613 euro. Këto të ardhura, janë të mjaftueshme vetëm për mbulimin e shpenzimeve të jetesës në shtetin grek për një familje me 3 anëtarë, për periudhën deri në vitin 2005²⁴.

20.8 Komisioneri Publik konstaton se në analizën financiare të Komisionit janë përfshirë të ardhurat e përfituara nga shfrytëzimi i ullinjve të vëllait të subjektit, z. ***.***, për periudhën 1994-2005, mbështetur në akt ekspertimi privat dhe në *deklarata të thjeshta, të disa shtetasve, pa datë*²⁵. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, çmon se këto të ardhura nuk bazohen në dokumentacion justifikues për të provuar masën e të ardhurave të pretenduara të realizuara, si dhe faktin nëse për to janë paguar detyrimet tatimore, në mënyrë që të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës. Në këtë pikë, Komisioneri Publik kërkon një qëndrim të qartë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pasi marrja parasyshe e këtyre akteve, deklaratave do të ndryshonte zërat në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

20.9 Në përfundim për pasurinë nr.1, Komisioni krijoi bindjen se:²⁶ [...] *subjekti ka deklaruar saktë këtë pasuri, si dhe burimin e ligjshëm të saj në Deklaratën “Vetting”. Subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie, për rrjedhojë nuk ngrihen dyshime, si dhe nuk provohet se subjekti ka pasur për qëllim të deklarojë në mënyrë të pasaktë burimin e kësaj pasurie. Në aneksin D të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 nuk parashikohen si shkak për shkarkim mospërputhjet në deklarime të subjektit në deklaratat periodike, të cilat nuk kanë pasur për qëllim fshehje ose paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurisë [...].*

20.10 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, marrë në konsideratë dhe jurisprudencën e Kolegjit,²⁷ konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas kërimit të shpjegimeve nga ana e Komisionit, nuk mund të konsiderohet si dokumentacion justifikues për ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, duke mos provuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me burime të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, blerjen e këtij apartamenti në vitin 2005.

20.11 Në përfundim të analizës së provave/akteve në dosje të Komisionit për pasurinë “Apartament 71 m²”, Komisioneri Publik vlerëson se, referuar nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, provohet deklarimi i pasaktë, i pamjaftueshëm dhe mungesa e burimeve të ligjshme

²⁴ Mbështetur në referencat e vendimit (JR) nr. 32/2019 të KPA-së.

²⁵ Tri deklaratat të shtetasve ***.***, ***.***, si përfaqësues ligjor i shoqërisë “****” sh.p.k., të z.***.***, si përfaqësues ligjor i subjektit “****” sh.p.k. dhe tetë mandate pagese të lëshuara (2011-2013) nga subjekti “****” sh.p.k.

²⁶ Referohuni vendimit të KPK-së (f. 7)

²⁷ Shihni vendimin e KPA-së (JR) nr. 12/2018 dhe vendimin (JR) nr. 32/2019.

për krijimin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për fitimin e pronësisë nga subjekti i rivlerësimit, mbi pasurinë nr.1.

21. Pasuria nr. 2 – “Apartament” me sip. 62.65 m², ndodhur në ***, Fier, rezulton i padeklaruar në D-Vett.

21.1 Në DV-2003 deklarohet: “Apartament banimi 2+1”, me sipërfaqe 74 m², në adresën “***”, Fier.

21.2 Gjatë hetimit administrativ, nga dokumentacioni i përcjellë nga ZVRPP Fier, me shkresën nr. *** prot., datë ***.3.2019, Komisioni informohet se subjekti i rivlerësimit ka në bashkë pronësi me prindërit dhe vëllain e saj (1/4 pjesë secili), pasurinë “Apartament” me sipërfaqe 62.65 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol.***, f ***, ***, Fier, fituar me kontratën e privatizimit në datën ***.12.1992.

21.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 4.12.2019, subjekti lidhur me adresën e kësaj pasurie deklaruar në DV-2003, ka sqaruar: “...Është një lapsus plotësimi në DV-2003 i adresës së shtëpisë, ku realisht banoja unë dhe familja ime, L. “***” në Fier, me adresën që i korrespondonte apartamentit të ndodhur në ***, Fier, për të cilën kam deklaruar 1/5 pjesë, sipas ligjit të privatizimit...”.

21.4 Në përfundim të hetimit, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit lidhur me mosdeklarimin e pjesës takuese të saj (1/4) në D-Vett.

21.5 Pas kalimit të barrës së provës, në shpjegimet e dhëna pas rezultateve të hetimit, datë 17.2.2020, subjekti ka deklaruar: “...është e vërtetë parregullsia ime në plotësimin e Deklaratës “Vetting” lidhur me këtë pasuri, për shkak të një harrese njerëzore ... mospërdorimit të saj faktik për një periudhë tejet të gjatë ... mungesës së dashjes për të mos ta deklaruar, mungesës së posedimit faktik të kësaj pasurie, vlerës së papërfillshme të saj në raport me pasuritë e mia ... urgjencës për të mbledhur dokumentacionin e nevojshëm për Vetting. Mungon qëllimi për të mosdeklaruar... kemi të bëjmë me një harresë të paqëllimshme, që nuk ka sjellë fshehje të pasurisë...”.

21.6 Lidhur me këtë mosdeklarim, Komisioni ka konkluduar se²⁸: [...] nga të gjitha rrethanat e faktit del se kemi të bëjmë me një harresë të paqëllimshme, që nuk ka sjellë fshehje të pasurisë, për aq kohë sa evidentohet në regjistrat hipotekorë, si dhe origjina e kësaj pasurie është nga privatizimi. Duke qenë se ky apartament është në pronësi të përbashkët midis subjektit dhe familjes të saj të origjinës, nuk evidentohen të dhëna që të lindin dyshime për fshehje apo veprime korruptive në blerje të kësaj pasurie. Pavarësisht kësaj, Komisioni vlerëson se mbetet fakt që subjekti nuk e ka deklaruar këtë bashkëpronësi në Deklaratën “Vetting”, duke e vënë subjektin në kushtet e pasaktësisë në deklarim, por që nuk ka pasur për qëllim fshehjen e pasurisë, duke mos përbërë në këtë mënyrë shkak për shkarkimin e subjektit [...].

21.7 Komisioneri Publik, ndryshe nga Komisioni lidhur me mosdeklarimin nga subjekti në D-Vett. të pasurisë në bashkëpronësi të subjektit me të afërmit e saj, vlerëson se subjekti ka pasur detyrimin ta deklarojë këtë pasuri bazuar në kërkesat e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr.

²⁸ Referohuni vendimit të KPK-së (f. 15).

84/2016. Për pasojë, në kuptim të nenit D, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e deklaramit të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë.

22. Pasuria nr. 3 - “Apartament” me sipërfaqe 66 m², Tiranë. *Në D-Vett*, deklarohet: “Apartament”, sipërfaqe 66 m², me adresë rr; “***.***”, Tiranë, për vlerën 1.400.000 lekë. Fituar me kontratën e shitblerjes nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2001. *Pjesa zotëruese*: 100 % në pronësi të bashkëshortit z.***.***. *Burimi i krijimit të pasurisë*: (i) Të ardhura nga paga, të kursyera gjatë viteve; (ii) të ardhura nga qiraja e objektit Fier (lokal-bar-bilardo).

22.1 *Në DV-2005* deklarohet: Apartament banimi (1+1), rruga e “****” sot “***.***”, për vlerën 23.000 USD, në pronësi të bashkëshortit z. ***.***. Nuk deklarohet burimi i pasurisë.

22.2 *Në DV-2006* deklarohet: Apartament banimi 1+1, me sipërfaqe 70 m², rruga e “****” Tiranë (deklaruar në 2005), blerë në vitin 2003 nga bashkëshorti *për vlerën 25.000 USD*. Nuk deklarohet burimi i pasurisë.

22.3 Nga dokumentacioni i përcjellë nga ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë ***.3.2019, rezulton se origjina e kësaj pasurie rrjedh nga kontrata e shitblerjes nr.*** rep. nr. *** kol., datë ***.12.2001, e apartamentit me vlerë n 1.400.000 lekë dhe kontrata e sipërmarrjes me nr.*** rep. dhe nr. *** kol., datë ***.10.2000, për vlerën 26.400 USD, të dyja të lidhura nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. ***.***, me shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k.

22.4 Në pikën 4 të kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep. dhe nr. *** , datë ***.10.2000, janë përcaktuar modalitetet e pagesës. Sipas saj, pagesa do të bëhet me katër këste: (i) kësti i parë prej 10.000 USD do paguhet në datën e nënshkrimit të kontratës, ***.10.2000; (ii) kësti i dytë prej 6.000 USD do të shlyhet në datën ***.2.2001; (iii) kësti i tretë prej 8.000 USD do të shlyhej në datën ***.7.2001 dhe (iv) kësti i katërt dhe i fundit, që përbën diferencën e mbetur të vlerës (2.400 USD), do të shlyhej në momentin e dorëzimit të apartamentit.

22.5 Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit²⁹, ndër të tjera, rezultojnë dhe disa mandate arkëtimi me numra rendorë, të vulosura dhe të nënshkruara nga administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., z. ***.***. Referuar këtyre mandateve, z. ***.*** ka paguar për këtë pasuri shumën totale prej 26.767 USD, konkretisht: i) mandat-arkëtimi nr. *** , datë ***.10.2000, për shumën 10.500 USD (kësti i parë); ii) mandat-arkëtimi nr.***, datë ***.7.2001, për shumën 4.860 USD; iii) mandat-arkëtimi nr.***, datë ***.12.2001, për shumën 4.755 USD; iv) mandat-arkëtimi nr.***, datë ***.2.2001, për shumën 6.000 USD; dhe v) mandat-arkëtimi nr.***, datë ***.4.2001, për shumën 652 USD.

22.6 I pyetur nga Komisioni mbi mospërputhjet: i) për çmimin dhe ii) burimin e deklaruar të këtij apartamenti, subjekti në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, datë 31.10.2019, ka deklaruar se “...diferenca e çmimit të kontratës së porosisë, çmimit në kontratën e shitblerjes dhe çmimit të deklaruar nga bashkëshorti... ju shpjegoj se, siç më ka vënë në dijeni bashkëshorti, ai kishte lidhur kontratën e porosisë, e cila kishte disa kushte specifike lidhur me cilësinë e punimeve që do të kryheshin dhe materialet që do të përdreshin parashikuar në nenin 11 të saj... Nga ana e shoqërisë ndërtuese nuk u zbatua ndonjëherë kjo pikë e kontratës dhe palët me marrëveshje arritën

²⁹ Nga dokumentacioni i përcjellë Komisionit nga ILDKPKI, me shkresë nr. *** prot., datë ***.2.2019.

në konsensus për shkak të materialeve të përdorura dhe punimeve jocilësore, ashtu siç ishin porositur, që apartamenti të merrej në dorëzim me kontratën e shitjes me çmim më të ulët...”. Mbi mospërputhjet e burimit: “...dua t’ju shpjegoj se është e vërtetë që kam deklaruar si burim të ardhurat nga biznesi dhe pagat e bashkëshortit, por pikërisht të ardhurat nga biznesi i referohen objektit “Bar-lojëra”, që ai kishte në pronësi dhe të ardhurat vileshin në formën e të ardhurave nga qiraja...”.

22.7 Komisioni ka vlerësuar se:³⁰ [...] nga analiza financiare konstatohet se bashkëshorti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie. Në përfundim nuk rezultojnë dyshime në lidhje me këtë pasuri të bashkëshortit të subjektit [...].

22.8 Lidhur me burimin e krijimit, të ardhura nga qiraja e godinës 2-katëshe në Fier, për vitet 1996-2001, rezulton se detyrimet tatimore mbi të ardhurat e pretenduara, të përfituara nga z. ***.**, janë paguar nga bashkëshorti i subjektit vetëm gjatë hetimit administrativ, vërtetuar me mandatin e Bankës **, datë **.12.2019. Komisioneri Publik, marrë në konsideratë jurisprudencën e Kolegjit³¹, lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore gjatë procesit të rivlerësimit, çmon se të ardhurat nga qiraja e godinës 2-katëshe në Fier, nuk na bindin për ligjshmërinë e tyre dhe mbeten një çështje për diskutim pranë KPA-së.

22.9 Gjithashtu, nga hetimi i kryer nga Komisioni pranë organeve tatimore³², rezulton se vëllezërit e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e qiramarrësve, nuk kanë ushtruar aktivitet privat Bar-lojëra fati për periudhën 1996-2001. Nuk evidentohet kryerja e pagesës së qirasë nëpërmjet sistemit bankar apo në ndonjë formë tjetër të parashikuar në legjislacionin në fuqi. Për të provuar të ardhurat e ligjshme, subjekti ka paraqitur deklarata noteriale të vëllezërve të saj³³, që referojnë në mënyrë kontradiktore shlyerjen e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e realizuara në vitet 1996-2001³⁴.

22.10 Në përfundim të analizës së provave/akteve në dosje të Komisionit për pasurinë “Apartament 66 m²”, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti në lidhje me këtë pasuri ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

23. Pasuria nr. 4 - “Dy garazhe me sipërfaqe 14 m², secili, ndodhur në adresën rr. “**.***.***”, Tiranë. *Në D-Vett*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: dy garazhe me sipërfaqe 14 m² secili, ndodhur në adresën rr. “**.***.***”, Tiranë, për vlerën totale prej 1.300.000 lekë. Pjesa takuese 100% në pronësi të bashkëshortit, z. **.***. Blerë me kontratë shitje nr. ** rep. nr.** kol., datë **.11.2013. Burim krijimi: (i) 1.000.000 lekë, përfituar nga shitja e 10% të aksioneve të bashkëshortit në shoqërinë “**.***” sh.a. (shumë të cilën e kemi patur *cash* në shtëpi); (ii) 300.000 lekë kursime nga paga.

23.1 *Në DV-2013*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pasurinë nr. 4.

23.2 Nga dokumentacioni i përcjellë nga ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. ** prot., datë **.3.2019, Komisioni informohet se bashkëshorti i subjektit i rivlerësimit ka në pronësi dy

³⁰ Referohuni vendimit të KPK-së (f.16).

³¹ Referohuni vendimit të KPA-së (JR) nr. 8/2019.

³² Referohuni shkresës nr. ** prot. datë **.12.2019, lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, Bashkia Fier.

³³ Deklaratë noteriale e z. **.***, nr. ** rep., nr. ** kol., datë **.12.2019 dhe deklaratë e thjeshtë, datë **.11.2019, e **.***.

³⁴ Referohuni vendimit të KPA-së (JR) nr. 10/2018.

garazhe me sipërfaqe 14 m² secili me nr. pasurie përkatësisht, *** dhe ***, në adresën rr. “***.***.***”, Tiranë.

23.3 (i) Mbi shumën 1.000.000 lekë, përfituar nga shitja e 10% të aksioneve të bashkëshortit, në shoqërinë “*” sh.a.**

23.4 Në DV-2009 deklarohet: të ardhura nga shitja 10% e aksioneve të biznesit “***” sh.a., me objekt lojëra fati, në shumën 2.000.000 lekë. Në rubrikën: “Ndryshimet e pasurive të personave të lidhur me të” deklarohet: *ndryshim në depozitë, shtesa të depozitës në Bankën ***, monedha USD, të siguruara nga shitja e aksioneve “***” sh.a., në shumën 21.000 USD.*

23.5 Në DV-2010 deklarohet: “...ndryshim në depozitë, tërheqje totale e depozitës në Banka ***, e siguruar nga shitja e 10% të aksioneve, 1.000.000 lekë për shlyerjen e detyrimit ndaj vëllait dhe 1.000.000 lekë janë dhënë hua”.

23.6 Duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar qartësisht, është pyetur nga Komisioni lidhur: i) me identifikimin e personit që ia ka dhënë këtë hua; ii) faktimin e dhënies dhe kthimit të huas dhe iii) ligjshmërinë e burimit të kësaj shume. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 datë 4.12.2019, ka deklaruar se: “...këtë hua z. ***,*** ia ka dhënë vajzës, shtetases ***,***, e cila kërkonte që të aplikonte për studime jashtë vendit. Kjo shumë është dhënë rreth muajit korrik-gusht 2010 dhe është kthyer në janar të vitit 2011. Bashkëshorti ka qenë i bindur se ka qenë brenda vitit dhe nuk ka pasur nevojë për ta shënuar kthimin e shumës...”.

23.7 Komisioni, pas shpjegimeve si më sipër, fillimisht ka vlerësuar se:³⁵ [...] “në kushtet kur bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar kthimin e huas nga e bija, shuma prej 1.000.000 lekë deklaruar dhënë hua, nuk duhet të përfshihet në analizën financiare për të vlerësuar aftësinë paguese të subjektit dhe personit të lidhur/bashkëshortit për blerjen dy garazheve me sip. 14m² secili, në shumën 1.300.000 lekë, në datën ***.11.2013 [...]”.

23.8 Në përfundim të hetimit, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime në lidhje me mosdeklarimin e shtesës së likuiditeteve në cash, në shumën 1.000.000 lekë, në DV-2011.

23.9 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit datë 17.2.2020, ka deklaruar se: “...nuk rezulton që bashkëshorti im të ketë bërë depozita të kësaj shume pas vitit 2010, moment që u tërhoq, dhe as të ketë investuar atë në blerjen e ndonjë pasurie. ...Z. *** kishte idenë se për sa kohë e kishte deklaruar të tërhequr nga banka dhe dhënë hua, fakti i kthimit të huas nuk ndikonte në deklarim, pasi ato ishin gjendje cash...”.

23.10 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se:³⁶ [...] “subjekti nuk ka qenë i saktë në deklarimin e gjendjes cash ndër vite, pasi ajo nuk ka deklaruar shumën 1.000.000 lekë (e cila ka burim të ligjshëm), por ndërkohë në D-Vett. ajo ka deklaruar saktësisht se shuma prej 1.000.000 lekësh ka shërbyer si burim për blerjen e garazheve. Mosdeklarimi i kthimit të shumës 1.000.000 lekë është një pasaktësi e subjektit në deklaratat periodike, por jo në D-Vett., për rrjedhojë, Komisioni pas shpjegimeve të dhëna të subjektit, si dhe mbështetur në analizën e mësipërme, do të përfshijë këtë shumë në analizën financiare të vitit 2013, duke e kthyer gjendjen e subjektit për këtë vit, pozitive [...]”.

³⁵ Referohu vendimit të KPK-së (f.17).

³⁶ Referohu vendimit të KPK-së (f.18).

23.11 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, konstatimi i Komisionit nuk mbështetet nga gjendja e akteve në dosje. Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar dhe jurisprudencës së deritanishme të KPA-së³⁷, subjekti dhe personat e lidhur me të kanë detyrimin të deklarojnë saktësisht dhe plotësisht ndryshimet në pasuri, detyrimet etj.

23.12 Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003 kthimin e huas në vitin 2011 dhe posedimin e *cash-it* në këtë vit, dhe si rrjedhojë nuk justifikohet me të ardhura nga burime të ligjshme shuma e depozituar pranë *** Bank në datën ***.11.2013, përdorur për blerjen e pasurisë nr. 4.

23.13 (ii) **Mbi shumën 300.000 lekë, kursime nga paga.** Nga gjendja e akteve të administruara në dosje rezulton se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të nga pagat dhe interesat bankare të përfituara për periudhën 1.1.2013 – 25.11.2013 janë në shumën 925.261 lekë³⁸, shpenzimet familjare janë në shumën 595.584 lekë dhe likuiditetet në bankë janë pakësuar në shumën 21.042 lekë. Subjekti mbulon me burime të ligjshme kursimin e deklaruar në këtë vit.

23.14 Në përfundim, për këtë pasuri, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj.

24. Pasuria nr. 5 - Autoveturë Mercedes Benz, modeli “B 180”. Në D-Vett. dhe DV-2014, deklarohet: Automjet Mercedes Benz, modeli “B 180”, vit prodhimi 2010, CDI, blerë në datën ***.6.2014, në pronësi të bashkëshortit të subjektit z. ***.***, për vlerën 6.557 euro. *Burimi i krijimit:* (i) të ardhura nga paga dhe (ii) huaja prej 5.000 euro, marrë babait të subjektit z. ***.***, nga vetë subjekti (shlyer totalisht gjatë vitit 2015, me të ardhurat familjare vjetore).

24.1 (i) **Mbi burimin të ardhura nga paga** - Komisionit nga analiza financiare për periudhën 1.1.2014 – 20.6.2014 i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

24.2 Komisioneri Publik vlerëson se analiza financiare për të vlerësuar mjaftueshmërinë e të ardhurave nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit të saj për të mbuluar blerjen e pasurisë dhe të shpenzimeve korente, duhej të shtrihej deri në datën 28.6.2014³⁹, që përkon me datën e pagesës së zhdoganimit të automjetit⁴⁰.

24.3 Për sa më sipër, marrë në konsideratë se të ardhurat⁴¹ për periudhën 1.1.2014 – 28.6.2014 janë në shumën 775.914 lekë dhe shpenzimet familjare për të njëjtën periudhë janë në shumën 550.967 lekë, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë realizuar të ardhura të mjaftueshme nga pagat, deklaruar si një nga zërat për blerjen e automjetit.

³⁷ Siç është trajtuar në pikën 19.13 të këtij ankimi.

³⁸ Në përlllogaritje janë marrë në konsideratë shpenzimet e jetesës për 3 persona për periudhën 1.1.2013 - 25.11.2013, shpenzimet e udhëtimit sipas të dhënave të sistemit TIMS, shpenzimet për qira sipas vetëdeklarimeve të subjektit, depozituar në dosjen e Komisionit, si dhe ndryshimi i likuiditeteve të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të në sistemin bankar, për të njëjtën periudhë.

³⁹ Rezulton se Komisioni ka analizuar mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të deri në datën 20.6.2010.

⁴⁰ Sipas Deklaratës Doganore, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në datën 28.6.2014, për vlerën e zhdoganimit, në shumën 187.757 lekë.

⁴¹ Përfshirë këtu pagat e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, nga pagat dhe interesat bankare.

24.4 (ii) Mbi huanë në shumën 5.000 euro nga babai, z.***.***. - Për të faktuar marrëdhënien e huas, subjekti ka depozituar pranë Komisionit kontratë huadhënieje, nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.11.2014, ku z. ***.*** i ka dhënë hua subjektit shumën 5.000 euro, në datën ***.6.2014.

24.5 Komisioni e ka konsideruar babain e subjektit, z. ***.***, si person tjetër të lidhur⁴² dhe ka hetuar lidhur me të ardhurat e realizuara prej tij.

24.6 Për të provuar aftësinë huadhënëse të babait të tij, subjekti, ndër të tjera, i ka paraqitur Komisionit si provë shkresore: i). Kontratë, datë ***.3.2006, për shitje trualli me sip. 682 m², në ***, Fier, në vlerën 150.000 lekë; ii) Kontratë, datë ***.4.2008, për shitje trualli me sip. 1507 m², në ***, Fier, në vlerën 1.478.367 lekë; iii) Kontratë datë ***.1.2009, për shitje trualli me sip. 540 m², në ***, Fier, në vlerën 529.740 lekë; iv) Vërtetim ISSH, Drejtoria Rajonale Fier nr. *** prot., datë ***.12.2019, për pension pleqërie, përfituar nga z. ***.***, për periudhën 2004-2012; v) Vërtetim, lëshuar ISSH, Drejtoria Rajonale Fier nr. *** prot., datë ***.12.2019, për pension pleqërie, përfituar nga z. ***.*** për periudhën 2013-2019; vi) Deklaratë e thjeshtë, pa datë, e shtetasit ***.*** dhe disa mandatpagesa; vii) Raport vlerësimi nga vlerësuesi ***.***, të datës ***.12.2019, për z. ***.***.

24.7 Komisioni, marrë në konsideratë provat dhe shpjegimet e subjektit, ka vlerësuar se⁴³: [...] *Siç rezulton nga dokumentacioni i depozituar, por edhe nga analiza financiare më poshtë, babai i saj ka pasur aftësi huadhënëse në shumën 5.000 euro [...].*

24.8 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, përfundimi i Komisionit nuk është i bazuar në gjendjen faktike të provave. Rezulton se Komisioni ka përfshirë në analizën e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, edhe shumën prej 5.841.438 lekë, në zërin të ardhura nga ullahtja, për periudhën 2006 - 28.6.2014. Për këto të ardhura, siç kemi argumentuar në pikën 19.33, nuk rezulton të jetë provuar ligjshmëria e tyre në përputhje të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës. Sa më sipër, huaja nuk mund të konsiderohet si burimi i ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie.

24.9 Në përfundim, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti, referuar nenit D, pika 3 të aneksit të Kushtetutës, nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait për huan e deklaruar dhe, rrjedhimisht, rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë nr. 5.

25. Pasuria nr. 6 - Autoveturë Mercedes Benz, modeli “ML 270” CDI, blerë në datën ***.9.2007 dhe shitur në datën ***.12.2016. Në D-Vett., në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike”, deklarohet të ardhura të krijuara nga shitja e automjetit Mercedes, ML 270, në shumën 900.000 lekë, sipas kontratës së shitjes nr.*** rep., nr.*** kol. datë ***.12.2016.

25.1 Në DV-2007 deklarohet: Blerje automjeti Benz-270, në vlerën 15.000 euro. Burimi i krijimit: (i) të ardhura nga shitja e mjetit Benz-190, në vlerën 4.000 USD, blerë më parë për vlerën 6.000 USD; (ii) lekët e depozituara në bankë, të tërhequra nga llogaria në USD (2006) dhe (iii) dhe kursime të vitit 2007.

⁴² Bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

⁴³ Referohuni vendimit të KPK-së (f. 20).

25.2 (i) **Mbi të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm, Benz-190, në vlerën 4.000 USD**; rezulton se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar të ardhurat nga shitja e këtij automjeti.

25.3 Komisioni fillimisht, në mungesë të dokumentacionit provues për shitjen e automjetit, nuk ka përfshirë në analizën financiare të burimeve të ligjshme të blerjes së kësaj pasurie, shumën 4.000 USD.

25.4 Lidhur më këtë fakt, në shpjegimet e subjektit, të dhëna pas rezultateve të hetimit datë 17.2.2020, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “... nga ana e bashkëshortit tim kjo shumë është deklaruar në DV-2007, faqe nr. 8. Kontrata e shitjes së mjetit nuk u bë e mundur të gjendet në dokumentet e DSHTRR, siç kam shpjeguar në pyetësin nr. 3”. ...Si dhe ka deklaruar se: “Ndodhem në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacionin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurisë, sipas nenit 32/2 të ligjit nr.84/2016...”.

25.5 Komisioni ka vlerësuar se subjekti⁴⁴ [...] ka bërë të gjitha përpjekjet, por, siç rezulton nga përgjigjja e DRSHTRR-së Tiranë, dosja e mjetit nuk gjendet, në këto kushte subjekti është në kushtet e pamundësisë... për të siguruar dokumentacion provues... dhe në vijim ka konkluduar se... shuma 4.000 USD do të përfshihet në analizë financiare... pasi shpjegimet e subjektit të mbështetura në prova krijojnë bindjen se ka pasur mundësi financiare për këtë veprim [...].

25.6 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, konkluzioni i mësipërm i Komisionit nuk mbështetet në gjendjen e akteve në dosje. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore në dosjen e ILDKPKI-së rezulton se vlera e blerjes së këtij automjeti në DV-2005 deklarohet 600 USD, ndërsa në DV-2007 (vit në të cilin është shitur) vlera e blerjes së automjetit deklarohet 6.000 USD.

25.7 Nisur nga mospërputhjet në deklarimin e çmimit të blerjes së automjetit Benz-190, në vlerësimin e Komisionerit Publik mbetet i paprovuar çmimi real i blerjes së tij, për të verifikuar nëse rezulton fitim nga transaksioni i shitjes së automjetit, fitim mbi të cilin do të duhej të aplikohet tatimi sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar).

25.8 (ii) **Mbi lekët e depozituara në bankë, të tërhequra nga llogaria në USD, në vitin 2006.** Në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 4.6.2009, në lidhje me burimet financiare të blerjes së automjetit, subjekti ka deklaruar: “...Në vitin 2006 kemi tërhequr nga këto depozita shumën 30.000 USD në datën ***.8.2006, të cilat janë përdorur nga bashkëshorti im ...Këto para janë depozituar në *** Bank, në muajin mars të vitit 2007, në shumën 11.000 euro⁴⁵, dhe kjo shumë është tërhequr për blerjen e automjetit tjetër me vlerë 15.000 euro, duke përdorur edhe lekët nga shitja e automjetit tjetër dhe kursimet në familje, deri në momentin e blerjes së këtij automjeti”.

25.9 Në shpjegimet e subjektit të dhëna pas rezultateve të hetimit datë 17.2.2020, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Analiza financiare për burimin e ligjshëm të të ardhurave për depozitën e kryer në datën 6.10.2005, të shumës 18.000 USD, të përdorura në vitin 2007 për blerjen e automjetit: Nga analiza financiare e të ardhurave, pasurive të blera dhe shpenzimet e

⁴⁴ Referohuni vendimit të KPK-së (f. 26).

⁴⁵ Nga verifikimi i lëvizjeve në llogaritë bankare të bashkëshortit, kjo shumë nuk rezulton e tërhequr deri në tetor 2007.

kryera për periudhën 1995 – 2005, rezulton se z. ***.*** ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar depozitën në shumën 12.000 euro, të cilat kanë qenë burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit në vitin 2007”. Konstatohet që në këtë deklaram, burimi i krijimit paraqitet i ndryshëm nga sa ka deklaruar në ILDKPKI, duke e lidhur burimin me depozitim që shtetasi ***.*** ka bërë në llogarinë e bashkëshortit në datën 9.7.2007, siç do të trajtohet në vijim, në pikën 26.1.

25.10 Në vijim Komisioni ka arsyetuar se:⁴⁶ [...] bashkëshorti i subjektit, pasi ka këmbyer shumën 18.000 USD në euro e ka tërhequr në datën 6.10.2005 dhe në këtë moment, subjekti nuk ka qenë ende në kushtet e bashkëjetesës/martesës ligjore me zotin ***.*** [...].

25.11 Në vlerësim të Komisionerit Publik, deklaramet e subjektit lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie në procesverbalet e mbajtur në ILDKPKI dhe shpjegimet gjatë hetimit administrativ, janë kontradiktore.

25.12 Në DV-2005 dhe DV-2006, nuk deklarohet kursime në cash në banesë. Komisioneri Publik çmon se, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (i ndryshuar), subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë cash-in në banesë, jashtë sistemit bankar në lekë ose valutë të huaj, si dhe çdo ndryshim të këtyre vlerave.

25.13 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, për shumatat e tërhequra nga llogaritë bankare në vitin 2005 dhe 2006, të padeklaruara si kursime në cash, Komisioneri, mbështetur dhe në jurisprudencën e deritanishme të KPA-së, siç kemi trajtuar dhe në pikën 19.13 të këtij ankimi, vlerëson se nuk duhet të konsiderohen si burime të ligjshme për blerjen e pasurisë nr. 6.

25.14 (iii) Për kursime të vitit 2007 - Në lidhje me këtë burim të deklaruar, rezulton se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të nga pagat dhe interesat bankare, për periudhën 1.1.2007 - 24.9.2007 janë në shumën 1.005.116 lekë⁴⁷, që nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë⁴⁸, ndryshimet në likuiditetet e depozituara në sistemin bankar⁴⁹ dhe blerjen e pasurisë automjet.

26. Çështje të tjera

26.1 Mbi transaksionin 12.000 euro në llogarinë e bashkëshortit të rivlerësimit

26.1.1 Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi i dokumentacionit bankar, Komisionit i ka rezultuar se në datën 9.7.2007, shtetasi ***.*** ka depozituar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit pranë ***, në cash, shumën 12.000 euro, e cila është tërhequr po cash nga bashkëshorti i subjektit në datën 6.9.2007. Subjekti ka deklaruar se kjo shumë i përket bashkëshortit të saj.

⁴⁶ Referohuni vendimit të KPK-së (f. 26).

⁴⁷ Të ardhurat përfshijnë të ardhurat familjare nga paga dhe dëshmipërblimet janar-shtator 2007, sipas kreditimeve në llogaritë bankare dhe të ardhurat nga interesat bankare.

⁴⁸ Shpenzimet e jetesës për 3 persona deri në shtator 2007 sipas ILDKPKI-së, bazuar në të dhënat e INSTAT-it, shpenzimet për udhëtime deri në shtator 2007.

⁴⁹ Sipas konfirmimeve të bankave të nivelit të dytë për likuiditetet deri në shtator 2007, në llogaritë e subjektit dhe personave të lidhur me të.

26.1.2 Nga analiza financiare, Komisionit i ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit, z. ***,***, nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar depozitën në shumën 12.000 euro në korrik të vitit 2007. Për këtë fakt, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

26.1.3 Në shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ, datë 17.2.2020, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “...Ato janë nga të ardhurat të krijuara e kursyera ndër vite, nga qiraja dhe shitja e pasurive të paluajtshme e të luajtshme të z. ***,***, ...z. ***, në *** Bank, në datën 6.10.2005 këmben shumën prej 18.000 USD në euro dhe e tërheq. ...Këtë shumë z. ***, jo vetëm nuk e ka deklaruar, por edhe as nuk e ka investuar në blerjen e ndonjë pasurie, por e ka mbajtur cash (lënë në ruajtje shtetasit ***,***), i cili e ka ridepozituar në vitin 2007, në llogarinë e z. *** pranë ***,***. ...Nuk e kemi kuptuar se kemi pasur detyrimin të deklarojmë edhe gjendjen e cash-it në banesë. Gjithsesi, të ardhurat në këto vite, tona... rezultojnë më të larta se shpenzimet e kryera dhe të dokumentuara. Prandaj, unë, si subjekt i rivlerësimit dhe bashkëshorti im ka pasur mundësi financiare për krijimin likuiditeteve dhe se nuk ka pasur qëllimin dhe dashjen për të bërë deklaram të pasaktë, deklaram të rremë apo fshehje pasurie.

26.1.4 Komisioni, në përfundim ka vlerësuar se:⁵⁰ [...] shpjegimet e subjektit, të mbështetura në prova, krijojnë bindjen se subjekti ka pasur mundësi financiare për këtë veprim [...].

26.1.5 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, që konsiderohen si provë gjatë hetimit administrativ, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të të kenë deklaruar kursime në cash në vitet 2005 dhe 2006.

26.2 **Mbi transaksionin 10.000 euro në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, z.***.***.**

26.2.1 Gjatë hetimit administrativ, nga lëvizjet e llogarisë në euro në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. ***,***, pranë *** Bank, ka rezultuar se, në datën 12.3.2002, është kryer transaksioni depozitim në cash, në shumën 10.000 euro, me përshkrimin: “Depozitim në arkë...nga Irena ***”.⁵¹

26.2.2 Në lidhje me këtë konstatim, subjekti, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 4.12.2019, ka deklaruar se: “...Dua të shpjegoj se llogaria nr. ***, është depozitë me afat dhe titullar i vetëm i saj është z. ***,***. ...se nuk kam pasur asnjë lidhje me këtë veprim bankar, si dhe nuk kam pasur në pronësinë time mbi asnjë pjesë të shumës së deklaruar më lart⁵²...i vetmi hamendësim se përse rezulton emri im si depozituese e shumës 10.000 euro, mund të jetë se veprimet janë kryer në degën Fier dhe ...ndoshta mund të kem shoqëruar z. *** pranë sportelit të bankës”.

26.2.3 Për sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se:⁵³ [...] lidhur me këtë transaksion, nuk ka paqartësi apo dyshime dhe kjo depozitë e ka origjinën e saj gjatë kohës së regjimit të parë martesor të z.*** [...]. Ndërsa në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpjegimet e subjektit mbeten thjesht në nivel deklarativ.

26.3 **Mbi huat e dhëna nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit**

⁵⁰ Referohuni vendimit të KPK-së (f. 27).

⁵¹ Sipas dokumentacionit bankar të *** Bank, përcjellë me shkresës nr. *** prot., datë ***,11.2019.

⁵² Për të mbështetur deklaramet e saj, subjekti ka depozituar edhe shkresën e *** Bank nr. *** prot., datë ***,12.2019.

⁵³ Referohuni vendimit të KPK-së (f. 22)

26.3.1 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka ardhur në dijëni për dy hua të dhëna shtetasit z. ***,***, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. ***,***,⁵⁴. (i) Me kontratë huaje nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.11.2008, rezulton se z. ***,*** i ka dhënë hua z. ***,*** për një periudhë 2 muaj e 4 ditë (kthimi është parashikuar në datën ***.1.2009), shumën 16.000 USD, me interes. (ii) Me kontratë huaje nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.4.2012, z. ***,*** i ka dhënë hua z. ***,***, për një periudhë 3-mujore, shumën 34.500 USD.

26.3.2 Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit mbi këto marrëdhënie, pasi nuk rezultojnë të deklaruara në deklaratat e interesave periodike vjetore të viteve respektive.

26.3.3 Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, datë 31.10.2019, subjekti: (i) për shumën 16.000 USD deklaroi se: *“Kjo shumë u kthye menjëherë nga z. ***, brenda vitit 2008, kjo është edhe arsyeja e mosdeklarimit ...në DV-2008 dhe as në D-Vett. ...Si burim për këtë kontratë janë përdorur të ardhurat e babait tim ... në kushtet e marrëdhënies së miqësisë së bashkëshortit tim me shtetasin z. ***, u krijua kjo marrëdhënie huaje, ku në fakt, si palë u pasqyrua vetëm bashkëshorti im dhe jo z. ***,***. Ky fakt provohet me deklaratën noteriale të z. ***,*** nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.11.2019. Për të vërtetuar kthimin e kësaj huaje, për shkak të marrëdhënies së miqësisë mes bashkëshortit tim dhe z. ***, nuk u pasqyrua kthimi në një deklaratë të menjëhershme noteriale. Kjo marrëdhënie u shua brenda 10 ditëve dhe z. *** e ka deklaruar me vullnetin e tij të lirë në deklaratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.11.2019”*. (ii) Për shumën 34.500 USD, subjekti ka deklaruar: *“Më lejoni të sqaroj, edhe kjo kontratë nuk është pasqyruar as në DV-2012, as në D-Vett., pasi ajo brenda vitit u shua si marrëdhënie juridike. Bashkëshorti im do të bashkëpunonte me z. *** dhe z. ***,*** në fushën e aktivitetit lojëra-fati, fushë në të cilën ka operuar edhe me shoqërinë “***” sh.a. dhe kishte eksperiencë të mëparshme...Kjo shumë 34.500 USD u sigurua nga një mik i bashkëshortit tim, z. ***,***... më pas i është kthyer pronarit të saj, z. *** nga ana e z. *** brenda po atij viti”*.

26.3.4 Për të provuar sa më sipër deklaruar, subjekti ka paraqitur edhe deklaratat noteriale të z. ***,***, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.11.2019, mandat-pagese pa numër të datës ***.12.2008, për kthimin e shumës 16.000 USD, firmosur nga ***,*** dhe ***,***, si dhe deklaratë noteriale të z. ***,***, me nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.11.2019. Subjekti ka depozituar gjithashtu dhe dokumentacion për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të personave të deklaruar si huadhënës, z. ***,***, për vitin 2008 dhe z. ***,***, për vitin 2012.

26.3.5 Komisioni ka vlerësuar se:⁵⁵ [...] Në lidhje me këtë hua (34.500 USD), subjekti ka depozituar dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të ardhurave të bashkëshortit të saj, të cilat kanë pasur si burim huan e marrë nga z.***,***. Nga hetimi rezultoi se z. *** kishte të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje ... Në lidhje me këtë hua (16.000 USD), subjekti ka depozituar dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të ardhurave të bashkëshortit të saj, të cilat kanë pasur si burim huan e marrë nga z.***,***. Nga hetimi rezultoi se z. ***,*** kishte të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje.

26.3.6 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, për dy huat e analizuara më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar as mënyrat e marrjes së shumave nga bashkëshorti ***,*** te

54 Konfirmuar dhe nga DPPP, me shkresën nr. *** prot., datë ***.5.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

55 Referohuni Vendimit të KPK (f. 27).

huadhënësit ***.*** dhe ***.***, dhe as kthimin e tyre, duke pamundësuar kontrollin financiar dhe ligjor të këtyre marrëdhënieve, përkundër detyrimit që ligji i njeh. Deklaratat noteriale të paraqitura nga subjekti rezultojnë se datojnë pas dorëzimit të D-Vett., janë administruar gjatë hetimit administrativ dhe, si të tilla, ashtu sikurse edhe pretendimet e subjektit, mbeten në nivelin deklarativ, nuk mund të konfirmojnë të vetme dhe jo në harmoni me prova të tjera, provueshmërinë që faktet e deklaruara në to kanë ndodhur realisht.

IV. Kërkimi i ankimit

27. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë, se ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

28. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

29. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

30. Bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F të aneksit të Kushtetutës, nenet 4 dhe 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016;

31. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 241, datë 26.2.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, zonjës Irena Gjoka.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA